



# FLETËNOTIM

# SCORECARD



**PRIZREN**

**SUHAREKË**

**MALISHEVË**

**RAHOVEC**

**DRAGASH**

**I - VI 2008**

**[www.kdi-kosova.org](http://www.kdi-kosova.org)**



## STAFI

**Ismet KRYEZIU**

*Drejtor Ekzekutiv*

**Bleranda ZOGAJ**

*Menaxhere e Programit*

**Valmir ISMAILI**

*Menaxher i Programit*

**Vjollca VOGËL**

*Administrata*

**Fitore ZENELI**

*Koordinatorë - Prishtinë*

**Ramadan KLISURICA**

*Koordinator - Prizren*

**Edita MUSTAFA**

*Këshilltare Profesionale*

**Violeta ZEKA**

*Këshilltare Profesionale*

*Dizajni Grafik*

**Arsim GJINOVC**

## PËRMBAJTJA

<b>1. Shpjegime mbi fletënotimin / Si ta lexojmë fletënotimin?</b>	<b>3</b>
<b>a. Komunat</b>	<b>3</b>
<b>b. Kategoritë</b>	<b>3</b>
<b>c. Periudha Kohore</b>	<b>3</b>
<b>d. Legjenda</b>	<b>3</b>
<b>2. Fletënotimet dhe analiza</b>	
<b>a. Prizren</b>	<b>4</b>
<b>b. Suharekë</b>	<b>8</b>
<b>c. Malishevë</b>	<b>12</b>
<b>d. Rahovec</b>	<b>16</b>
<b>e. Dragash</b>	<b>20</b>
<b>3. Analiza krahasuese mbi punën e Kuvendeve Komunale</b>	
<b>I. Hyrje</b>	<b>24</b>
<b>II. Angazhimi i këshilltarëve për një legjislativ efikas</b>	<b>25</b>
<b>III. Transparenca e degës legjislative</b>	<b>28</b>
<b>IV. Përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje</b>	<b>30</b>

## SI TA LEXOJMË FLETNOTIMIN?

### NOTIMI

Vlerësimet janë të bazuara në vëzhgimin e drejtpërdrejtë dhe objektiv të punimeve të Kuvendeve Komunale. Monitoruesit e Institutit Demokratik të Kosovës kanë përcjellë të gjitha seancat e gjashtë Kuvendeve Komunale gjatë periudhës Janar - Qershor 2008. Për më tepër, monitoruesit e KDI-së kanë realizuar një numër të konsiderueshëm të takimeve individuale me shumë anëtarë, kanë organizuar seri të tryezave dhe debateve në çështje të ndryshme. Anëtarët komunalë dhe subjektet politike janë notuar veç e veç në secilën nga pesë kategoritë e lartpërmendura si dhe mbi performancën dhe angazhimet e tyre në përgjithësi. Rezultatet e notimeve janë të shprehura në përqindje (%).

### KOMUNAT

Ky fletënotim përmban analiza dhe statistika mbi punën e anëtarëve që përfaqësojnë 13 subjekte politike në Kuvendet Komunale në vijim: Prizren, Suharekë, Malishevë, Rahovec dhe Dragash.

### KATEGORITË

KDI në këtë fletënotim ka pasqyruar dhe analizuar në mënyrë të përgjithshme performancën si dhe angazhimet e anëtarëve komunalë dhe subjekteve politike në 2 kategori të paraqitura në vijim të cilat janë të ndara në nënkategori:

#### I. Performanca dhe roli i anëtarit në legjislativ

1. Pjesëmarrja e anëtarëve dhe subjekteve politike në diskutimet gjatë seancave të Kuvendit Komunalë
2. Inicimi i çështjeve me interes të përgjithshëm për qytetarët
3. Inicimi i rregulloreve të reja komunale
4. Propozimi i amandamenteve në legjislacionin ekzistues

#### II. Performanca dhe roli i anëtarit në mbikëqyrjen e degës së ekzekutivit

1. Pyetjet parlamentare

#### III. Analiza për fusha të veqanta në legjislativin lokal për regjionin e Prizrenit

1. Hyrje
2. Angazhimi i këshilltarëve për një legjislativ efikas
3. Transparenca e degës legjislative
4. Përfshirja e qytetarëve në vendimmarrje

### PERIUDHA KOHORE

Notimi i anëtarëve komunalë dhe subjekteve politike është bërë për periudhën 6 mujore, Janar-Qershor 2008.

### LEGJENDA

- \* - Kryetari i AK-se
- \*\* - Shefat e Grupeve Parlamentare
- \*\*\* - Anëtarët e ri të Kuvendit

**REZULTATET E NOTIMEVE PËR ANËTARËT E KUVENDIT KOMUNAL PRIZREN  
PËR PERIUHDHËN JANAR - QERSHOR 2008**

KUVENDI KOMUNAL PRIZREN			Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave	Inicimi i çështjeve	Inicimi i rregulloreve	Amandamentimi i legjislaionit	Pyetje parlamentare	Notimi i përgjithshëm 2008
Nr	Këshillëtarët e Kuvendit Komunal	Subjekti politik	%	%	%	%	%	%
1	Afrim Avdaj	PDK	1.7%	1.4%	0	0%	8.8%	3.0%
2	Bedri Hoxha	PDK	0.9%	1.4%	0	0%	0%	0.6%
3	Besnik Krasniqi	PDK	2.3%	2.3%	0	0%	2.9%	1.9%
4	Ethem Rugova	PDK	3.7%	3.6%	0	0%	2.9%	2.6%
5	Hasan Hasani**	PDK	9.7%	8.2%	0	0%	0%	4.5%
6	Hajrim Qengaj	PDK	0.6%	0.5%	0	0%	0%	0.3%
7	Mybexhel Zhuri	PDK	0.3%	0%	0	0%	0%	0.1%
8	Natyre Mullafetahu	PDK	0.3%	0%	0	0%	0%	0.1%
9	Nehale Shendeti	PDK	0%	0%	0	0%	0%	0%
10	Nijazi Kryeziu**	PDK	5.1%	2.3%	0	0%	0%	1.9%
11	Sylbije Osmanaj	PDK	0%	0%	0	0%	0%	0%
12	Shukri Quni***	PDK	0%	0%	0	0%	0%	0%
13	Agim Muçaj	LDK	5.1%	8.6%	0	0%	2.9%	4.2%
14	Hasan Hoti	LDK	0.6%	3.2%	0	0%	0%	0.9%
15	Haziz Hodaj**	LDK	10.3%	14.1%	0	0%	2.9%	6.8%
16	Kimete Hoxha	LDK	1.4%	2.7%	0	0%	2.9%	1.8%
17	Masar Shporta	LDK	2.0%	1.8%	0	0%	8.8%	3.2%
18	Mybera Mustafa	LDK	0.9%	0.5%	0	0%	0%	0.3%
19	Qamil Buzhala	LDK	0%	0%	0	0%	0%	0%
20	Ridvan Hoxha	LDK	6.0%	8.6%	0	0%	8.8%	5.9%
21	Semahate Mashkulli	LDK	1.4%	2.3%	0	0%	2.9%	1.7%
22	Xhevat Xhoxhaj	LDK	0.9%	2.3%	0	0%	5.9%	2.3%
23	Adelina Beqiri	AKR	2.3%	0%	0	0%	0%	0.6%
24	Agim Susuri	AKR	0%	0%	0	0%	0%	0%
25	Faik Miftari**	AKR	2.8%	7.7%	0	0%	2.9%	3.4%
26	Trendelina Spahiu	AKR	0%	0%	0	0%	0%	0%
27	Ajshë Shala	AAK	0.6%	0.5%	0	0%	0%	0.3%
28	Fatmir Kastrati	AAK	0.9%	2.3%	0	0%	0%	0.8%
29	Masar Shala	AAK	7.4%	4.5%	0	0%	11.8%	5.9%
30	Ercan Şpat	KDTP	1.7%	0.5%	0	0%	2.9%	1.3%
31	Enis Subi	KDTP	1.4%	0%	0	0%	0%	0.4%
32	Müveddet Bako	KDTP	1.7%	0%	0	0%	0%	0.4%
33	Çemalij Kurtişi	VAKAT	4.0%	1.8%	0	0%	0%	1.5%
34	Memnuna Ajdini	VAKAT	1.7%	0%	0	0%	0%	0.4%
35	Dželilij Elezi	VAKAT	0.6%	0%	0	0%	0%	0.1%
36	Haki Gajraku	LDD	5.4%	5.0%	0	0%	11.8%	5.5%
37	Sebahate Ahmetaj	LDD	1.4%	0%	0	0%	0%	0.4%
38	Besnik Krajku	ORA	2.3%	1.8%	0	0%	2.9%	1.8%
39	Vjosa Curri	ORA	1.7%	1.4%	0	0%	8.8%	3.0%
40	Ajni Sinani	PD	5.1%	5.5%	0	0%	2.9%	3.4%
41	Abaz Ademi	SDA	6.0%	5.5%	0	0%	5.9%	4.3%
<b>Rezultatet e notimeve për subjektet politike në seanca</b>			Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave	Inicimi i çështjeve	Inicimi i rregulloreve	Amandamentimi i legjislaionit	Pyetje Parlamentare	Notimi i përgjithshëm 2008
Nr	Subjektet politike	Numri i anëtarëve						
1	PDK	12	24.5%	19.5%	0%	0%	14.7%	17.1%
2	LDK	10	28.5%	44.1%	0%	0%	35.3%	39.7%
3	AKR	4	5.1%	7.7%	0%	0%	2.9%	5.3%
4	AAK	3	8.8%	7.3%	0%	0%	11.8%	9.5%
5	KDTP	3	4.8%	0.5%	0%	0%	2.9%	1.7%
6	VAKAT	3	6.3%	1.8%	0%	0%	0%	0.9%
7	LDD	2	6.8%	5.0%	0%	0%	11.8%	8.4%
8	ORA	2	4.0%	3.2%	0%	0%	11.8%	7.5%
9	PD	1	5.1%	5.5%	0%	0%	2.9%	4.2%
10	SDA	1	6.0%	5.5%	0%	0%	5.9%	5.7%

**LEGJENDA**

\* - Kryetari i AK-së

\*\* - Shefat e Grupeve Parlamentare

\*\*\* - Anëtarët e ri të Kuvendit

Rr - Rregulloret e propozuara

NOTIMI I PËRGJITHSHËM

Kuvendi Komunal i Prizrenit numëron gjithsej 41 anëtarë, të cilët përfaqësojnë 10 subjekte politike (PDK, LDK, AKR, AAK, KDTP, VAKAT, ORA, LDD, PD, SDA).

**Anëtarët që kanë shënuar rezultatet më të kënaqshme në të gjitha kategoritë janë:**

Haziz Hodaj	LDK	6.8%
Ridvan Hoxha	LDK	5.9%
Masar Shala	AAK	5.9%
Haki Gajraku	LDD	5.5%

**Anëtarët që nuk kanë shënuar asnjë rezultat në të gjitha kategoritë (0%):**

Nehale Shendeti	PDK	0%
Sylbije Osmanaj	PDK	0%
Shukri Quni	PDK	0%
Qamil Buzhala	LDK	0%
Agim Susuri	AKR	0%
Trëndelina Spahiu	AKR	0%

**Anëtarët që kanë shënuar rezultatet më të ulëta në të gjitha kategoritë në përgjithësi janë:**

Enis Subi	KDTP	0.4%
Müveddet Bako	KDTP	0.4%
Sebahate Ahmetaj	LDD	0.4%
Memnuna Ajdini	VAKAT	0.4%
Hajrim Qengaj	PDK	0.3%
Mybera Mustafa	LDK	0.3%
Ajshe Shala	AAK	0.3%
Mybexhel Zhuri	PDK	0.1%
Natyra Mullafetahu	PDK	0.1%
Dželjilj Elezi	VAKAT	0.1%

**Notimi i përgjithshëm i kryetarëve të grupeve parlamentare të partive politike PDK, LDK, AKR, AAK është si vijon:** Hasan Hasani PDK 4.5 %, Nijazi Kryeziu PDK 1.9 %, Haziz Hodaj LDK 6.8 %, Faik Miftari AKR 3.4%, Masar Shala AAK 5.9%.

*(Si rezultat i përplasjeve brenda partiake, anëtarët e PDK-së në Kuvendin Komunal të Prizrenit përfaqësohen nga dy "kryetarë" të grupeve parlamentare, Hasan Hasani që përfaqëson 4 anëtarë të Kuvendit Komunal të Prizrenit nga radhët e PDK dhe Nijazi Kryeziu që përfaqëson 8 anëtarë të tjerë të PDK-së në Kuvendin Komunal të Prizrenit.)*

MUNGESAT NË SEANCA


Gjatë periudhës Janar-Qershor 2008 anëtarët e Kuvendit Komunal të Prizrenit kanë treguar motiv të lartë për të marrë pjesë në punimet e Kuvendit. Gjatë kësaj periudhe nuk është evidentuar asnjë anëtar i Kuvendit Komunal të Prizrenit me pjesëmarrje më të ulët se 50% në seanca.

TRENDI I DISKUTIMEVE


Niveli i pjesëmarrjes në diskutime i anëtarëve të Kuvendit Komunal të Prizrenit gjatë seancave për periudhën Janar- Qershor 2008 lëviz nga kuota më e ulët e shënuar në muajin Maj prej 41% deri në kuotën më të lartë 70% të shënuar në seancën e muajit Mars. Ndërkaq 65% e angazhimit të anëtarëve në diskutime kanë qenë të karakterit procedural.

Nga 41 anëtarë të këtij kuvendit komunal 6 prej tyre asnjëherë nuk kanë marrë pjesë në diskutime gjatë seancave. Nga ana tjetër, nga 14 anëtare të gjinisë femërore sa ka Kuvendi Komunal i Prizrenit 3 prej tyre asnjëherë nuk kanë diskutuar në seancat e mbajtura gjatë periudhës Janar- Qershor 2008.

Trendi i diskutimeve të anëtarëve të kuvendit komunal në seancat Janar- Qershor 2008



Niveli i diskutimeve sipas subjektit politik



Përfaqësimi i subjekteve politike në KK

## ÇËSH TJET E INICUARA


Anëtarët e Kuvendit Komunal të Prizrenit gjatë seancave plenare për periudhën Janar-Qershor 2008 kanë trajtuar gjithsej 220 çështje të natyrave të ndryshme që lidhen me brengat të qytetarëve. Nga 41 anëtarë të Kuvendit Komunal të Prizrenit, 27 prej tyre ose shprehur në përqindje 65.8% e tyre kanë ngritur në diskutim çështje të natyrave të ndryshme. Anëtari më aktiv gjatë kësaj periudhe në ngritjen e çështjeve për diskutim në Kuvendin Komunal të Prizrenit qenë Haziz Hodaj (LDK) me 14.1%.

## INICIMI I ÇËSH TJJEVE SIPAS SUBJEKTIT POLITIK

Koalicionin qeveritar e përbëjnë partitë në pozitë PDK, AKR, KDTP dhe VAKAT me gjithsej 22 anëtarë të Kuvendit komunal, ndërsa parti në opozitë LDK, AAK, LDD, ORA, PD, SDA me gjithsej 19 anëtarë të këtij kuvendi komunal.

Nga trajtimi i çështjeve në Kuvendin Komunal të Prizrenit ,70.6% e çështjeve janë ngritur për trajtim nga radhët e opozitës ndërsa 29.5% të çështjeve janë ngritur nga pozita.


Inicimi i çështjeve sipas subjektit politik



Përfaqësimi i subjekteve politike në KK

## LLOJET E ÇËSH TJJEVE

Nga ana tjetër anëtarë e kuvendit komunale janë treguar shumë të zëshëm në çështjet që kanë të bëjnë me themelimin e organeve komunale, gjegjësisht ato çështje që kanë të bëjnë me ndarjen e pastës së pushtetit. Çështjet të cilat janë ngritur për diskutim nga ana e anëtarëve të Kuvendit Komunal të Prizrenit janë çështje të natyrave të ndryshme kryesisht çështje të karakterit procedural, çështje me interes ose brenga të qytetarëve me karakter infrastrukturor, ekonomi, ambient, shëndetësi, arsim dhe çështje të tjera.



**Disa nga çështjet të cilat janë shtruar për diskutim në seancat e Kuvendit Komunal të Prizrenit janë:**

- Numri i drejtorive të Komunës së Prizrenit,
- Emërimi i drejtorit të Drejtorisë së Administratës dhe Personelit,
- Shqyrtimi i propozim vendimit për anulimin e Vendimit të Asamblesë Komunale të KK-së së Prizrenit lidhur me përcaktimin e kushteve të përkohshme të objekteve në territorin e komunës së Prizrenit.
- Raporti i Kryetarit të Komunës.

## RREGULLORET E INICUARA

**Në Kuvendin e komunës së Prizrenit gjatë periudhës Janar-Qershor 2008 nuk është iniciuar asnjë rregullore nga ana e anëtarëve të Kuvendit Komunal njëherit nuk është sponsorizuar asnjë rregullore as nga dega ekzekutive apo komisionet e kuvendit. Gjatë kësaj periudhe Kuvendi ka proceduar dhe miratuar 28 propozim-vendime prej të cilave 16 janë propozim vendime lidhur me formimin e komiteteve, zgjedhjen e drejtorëve etj.**

## PROPOZIMI I AMANDAMENTEVE


Anëtarët e Kuvendit Komunal të Prizrenit, gjatë periudhës Janar-Qershor nuk kanë bërë asnjë propozim apo amendamentim për ndonjë rregullore të re.

## PYETJET E PARASHTRUARA GJATË SEANCEVE

Në Kuvendin Komunal të Prizrenit janë regjistruar 34 pyetje të anëtarëve të këtij kuvendi si instrument për të ndihmuar ndërtimin e raportit për llogaridhënie të degës së ekzekutivit përballë legjislativit komunal.

Më së shumti pyetje janë parashtruar në seancën e muajit Prill 11 pyetje dhe në seancën e muajit Qershor 10 pyetje, përdërisa në tre seancat tjera, kemi 3 deri 6 pyetje për seancë.

Pyetjet Parlamentare



Përfaqësimi i subjekteve politike në KK

**Nga 41 anëtarë të Kuvendit Komunal të Prizrenit, 18 prej tyre ose shprehur në përqindje 43.90% e tyre kanë parashtruar pyetje të natyrave të ndryshme.**

Në vazhdim pasqyrojmë emrat e anëtarëve që kanë treguar më shumë angazhim në parashtrimin e pyetjeve gjatë kësaj periudhe: Masar Shala AAK 11.76%, Haki Gajraku LDD 11.76%, Afrim Avdaj PDK 8.82%, Masar Shporta LDK 8.82%, Ridvan Hoxha LDK 8.82%, Vjosa Curri ORA 8.82%.

**REZULTATET E NOTIMEVE PËR ANËTARËT E KUVENDIT KOMUNAL SUHAREKË  
PËR PERIUHDËN JANAR - QERSHOR 2008**

KUVENDI KOMUNAL SUHAREKË			Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave	Inicimi i çështjeve	Inicimi i rregulloreve	Amandamentimi i legjislativitetit	Pyetje parlamentare	Notimi i përgjithshëm 2008
Nr	Këshillëtarët e Kuvendit Komunal	Subjekti politik						
1	Avdyll Sopaj	LDK	2.8%	0%	0%	0%	5.3%	2.0%
2	Bashkim Berisha	LDK	1.9%	0%	0%	0%	0%	0.5%
3	Bexhet Kuçi	LDK	0.9%	0%	0%	0%	0%	0.2%
4	Fetie Kuçi	LDK	0%	0%	0%	0%	0%	0.0%
5	Halit Elshani	LDK	5.6%	0%	0%	0%	0%	1.4%
6	Hidajete Haliti	LDK	0%	0%	0%	0%	0%	0.0%
7	Kimete Bytyçi	LDK	1.9%	3.0%	0%	0%	5.3%	2.5%
8	Lira Mala	LDK	0%	0%	0%	0%	0%	0.0%
9	Malsore Elshani	LDK	0%	0%	0%	0%	0%	0.0%
10	Nazim Zenelaj	LDK	4.6%	3.0%	0%	0%	10.5%	4.5%
11	Ramadan Haxhijaj	LDK	4.6%	3.0%	0%	0%	5.3%	3.2%
12	Remzi Bytyçi	LDK	1.9%	3.0%	0%	0%	0%	1.2%
13	Rexhep Kuçi**	LDK	4.6%	3.0%	0%	0%	0%	1.9%
14	Sami Jupa	LDK	7.4%	9.1%	0%	0%	15.8%	8.1%
15	Shaqir Kryeziu	LDK	2.8%	6.1%	0%	33.3%	0%	10.5%
16	Shukrie Salihu	LDK	0%	0%	0%	0%	0%	0.0%
17	Vitor Markaj	LDK	4.6%	0%	0%	0%	0%	1.2%
18	Xhemajli Shala***	LDK	5.6%	9.1%	0%	0%	5.3%	5.0%
19	Adem Kadolli	PDK	5.6%	9.1%	0%	0%	0%	3.7%
20	Arif Daka	PDK	0%	0%	0%	0%	0%	0.0%
21	Driton Krasniqi	PDK	0.9%	0%	0%	0%	5.3%	1.5%
22	Elmaze Kabashi	PDK	0%	0%	0%	0%	0%	0.0%
23	Fatmir Guraziu	PDK	0%	0%	0%	0%	0%	0.0%
24	Hanife Rakaqi	PDK	0%	0%	0%	0%	0%	0.0%
25	Hazir Hajdari	PDK	5.6%	6.1%	0%	33.3%	0%	11.2%
26	Muhamet Veliu	PDK	8.3%	15.2%	0%	33.3%	0%	14.2%
27	Rexhep Manxhuka	PDK	5.6%	15.2%	0%	0%	21.1%	10.4%
28	Safet Hoxha**	PDK	7.4%	9.1%	0%	0%	10.5%	6.8%
29	Sevdije Sadiku	PDK	0%	0%	0%	0%	0%	0.0%
30	Shkurte Morina	PDK	3.7%	3.0%	0%	0%	10.5%	4.3%
31	Zoja Zenelaj	PDK	0%	0%	0%	0%	0%	0.0%
32	Xheladin Buqa	PDK	1.9%	0%	0%	0%	0%	0.5%
33	Bahrije Kokollari	LDD	0.9%	0%	0%	0%	0%	0.2%
34	Leonora Reshitaj	LDD	0%	0%	0%	0%	0%	0.0%
35	Muhamet Bajraktari**	LDD	1.9%	0%	0%	0%	0%	0.5%
36	Urim Suka***	LDD	1.9%	3%	0%	0%	0%	1.2%
37	Nadire Hoxha	AAK	1.9%	0%	0%	0%	0%	0.5%
38	Vesel Maliqaj	AAK	2.8%	0%	0%	0%	5.3%	2.0%
39	Haxhi Sallauka	AKR	1.9%	0%	0%	0%	0%	0.5%
40	Sevdije Berisha	AKR	0.9%	0%	0%	0%	0%	0.2%
41	Isuf Krasniqi	PD	0%	0%	0%	0%	0%	0.0%

Rezultatet e notimeve për subjektet politike në seanca			Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave	Inicimi i çështjeve	Inicimi i rregulloreve	Amandamentimi i legjislativitetit	Pyetje Parlamentare	Notimi i përgjithshëm 2008
Nr	Subjektet politike	Numri i anëtarëve						
1	LDK	18	49.1%	39.4%	0%	0%	47.4%	43.4%
2	PDK	14	38.9%	57.6%	0%	0%	47.4%	52.5%
3	LDD	4	4.6%	3.0%	0%	0%	0%	1.5%
4	AAK	2	4.6%	0%	0%	0%	5.3%	2.6%
5	AKR	2	2.8%	0%	0%	0%	0%	0.0%
6	PD	1	0%	0%	0%	0%	0%	0.0%

Prej datës 21.04.2008, dy anëtarët të ri janë kyçur në Kuvendit Komunal të Suharekës, ata janë: Xhemajli Shala dhe Urim Suka

**LEGJENDA**

\* - Kryetari i AK-së

\*\* - Shefat e Grupeve Parlamentare

\*\*\* - Anëtarët e ri të Kuvendit

Rr - Rregulloret e propozuara



## NOTIMI I PËRGJITHSHËM

Kuvendi Komunal i Suharekës numëron gjithsej 41 anëtarë, të cilët përfaqësojnë 6 subjekte politike (LDK, PDK, LDD, AAK, AKR, PD).

### Anëtarët që kanë shënuar rezultatet më të kënaqshme në të gjitha kategoritë janë:

Muhamet Veliu	PDK	14.2 %
Hazir Hajdari	PDK	11.2 %
Shaqir Kryeziu	LDK	10.5 %
Rexhep Manxhuka	PDK	10.4 %

### Anëtarët që nuk kanë shënuar asnjë rezultat në të gjitha kategoritë (0%):

Fetie Kuçi	LDK	0%
Hidajete Haliti	LDK	0%
Lira Mala	LDK	0%
Malsore Elshani	LDK	0%
Shukrie Salihu	LDK	0%
Arif Daka	PDK	0%
Elmaze Kabashi	PDK	0%
Hanife Rakaqi	PDK	0%
Sevdije Sadiku	PDK	0%
Zoja Zenelaj	PDK	0%
Leonora Reshitaj	LDD	0%
Isuf Krasniqi	PD	0%

### Anëtarët që kanë shënuar rezultatet më të ulëta në të gjitha kategoritë në përgjithësi (0.1-0.5%) janë:

Bashkim Berisha	LDK	0.5%
Xheladin Buqa	PDK	0.5%
Muhamet Bajraktari	LDD	0.5%
Nadire Hoxha	AAK	0.5%
Haxhi Sallauka	AKR	0.5%
Bexhet Kuçi	LDK	0.2%
Bahrije Kokollari	LDD	0.2%
Sevdije Berisha	AKR	0.2%

**Notimi i përgjithshëm i kryetarëve të grupeve parlamentare të partive politike LDK, PDK, LDD është si vijon:** Safet Hoxha PDK 6.8%, Rexhep Kuçi LDK 1.9%, Muhamet Bajraktari LDD 0.5%.

## MUNGESAT NË SEANCA

Anëtarët e Kuvendit Komunal që kanë shënuar pjesëmarrje më të ulët në seanca (nën 50%) janë:


Arif Daka PDK 20%, Fatmir Guraziu PDK 20%, Xheladin Buqa PDK 20%, Malsore Elshani LDK 40%, Hanife Rakaqi PDK 40%

## TRENDI I DISKUTIMEVE


Niveli më i ulët i pjesëmarrjes në diskutime të anëtarëve të Kuvendit Komunal të Suharekës gjatë seancave të mbajtura në periudhën Janar- Qershor 2008 është shënuar në seancën e muajit Janar me 17%, ndërsa niveli më i lartë i pjesëmarrjes në diskutim është shënuar në seancën e 4 Qershor me 46%.

Nga 41 anëtarë të Kuvendit Komunal të Suharekës, 13 prej tyre asnjëherë nuk kanë marrë pjesë në diskutime gjatë seancave dhe njëkohësisht nuk kanë ngritur ndonjë çështje në interes të qytetarëve gjatë kësaj periudhe.

Trendi i diskutimeve të anëtarëve të kuvendit komunal në seancat Janar- Qershor 2008



Niveli i diskutimeve sipas subjektit politik



Përfaqësimi i subjekteve politike në KK

## ÇËSHTJET E INICUARA


Anëtarët e Kuvendit Komunal të Suharekës gjatë seancave të mbajtura për periudhën Janar-Qershor 2008 nga totali i çështjeve të inicuar 75% e tyre janë çështje të cilat prekin drejtpërdrejt brengat e qytetarëve ndërsa 25% prej tyre kanë qenë çështje të karakterit procedural.

Nga 41 anëtarë të Kuvendit Komunal të Suharekës, 15 prej tyre ose shprehur në përqindje 36% e tyre kanë ngritur në diskutim çështje të natyrave të ndryshme.

Anëtarë më aktiv gjatë kësaj periudhe në ngritjen e çështjeve për diskutim në Kuvendin Komunal të Suharekës kanë qenë: Muhamet Veliu (PDK) me 15.2% dhe Rexhep Manxhuka (PDK) me 15.2%.

Lidhur me nivelin e ngritjes së çështjeve për diskutim në seancat e Kuvendit Komunal të Suharekës opozita ka qenë më e zëshme dhe ka ngritur gjithsej 57% të çështjeve ndërsa pozita ka ngritur gjithsej 43% të çështjeve të natyrave të ndryshme.

Inicimi i çështjeve sipas subjektit politik




Përfaqësimi i subjekteve politike në KK

## LLOJET E ÇËSHTJEVE

Çështjet të cilat janë ngritur për diskutim nga ana e anëtarëve të Kuvendit Komunal të Suharekës janë çështje të natyrave të ndryshme kryesisht çështje të karakterit procedural, çështje me interes ose brenga të qytetarëve me karakter infrastrukturor, ekonomi, ambient, shëndetësi, arsim dhe çështje të tjera.

**Disa nga çështjet të cilat janë shtruar për diskutim në seancat e Kuvendit Komunal të Suharekës janë:**



- Projekt vendimi mbi caktimin e numrit të drejtorive komunale,
- Projekt vendimi mbi aprovimin e Planit Zhvillimor Komunal dhe Urban,
- Shqyrtimi i projekt vendimit për hartimin e Planit Rregullues Urban për zonën industriale në Shirokë,
- Shqyrtimi i projekt Statutit të Komunës së Suharekës.

## RREGULLORET E INICUARA

**Gjatë periudhës Janar-Qershor 2008 në Kuvendin Komunal të Suharekës nuk është iniciuar asnjë rregullore nga ana e anëtarëve të këtij kuvendi.**

**Në këtë periudhë Kuvendi Komunal i Suharekës ka aprovuar gjithsej 25 vendime, 18 prej tyre ishin vendime lidhur me formimin e komiteteve, emërimin e drejtorëve etj.**


## PROPOZIMI I AMANDAMENTEVE

Anëtarët e Kuvendit Komunal të Suharekës gjatë periudhës Janar-Qershor kanë propozuar 3 amandamente të vendimeve përkatëse.

## PYETJET E PARASHTRUARA GJATË SEANCEVE

Gjatë kësaj periudhe në Kuvendin Komunal të Suharekës janë regjistruar 19 pyetje të anëtarëve si instrument për të ndihmuar ndërtimin e raportit për llogaridhënie të degës së ekzekutivit përballë legjislativit komunal.

Niveli më i lartë i parashtrimit të pyetjeve është regjistruar në seancën e muajit Mars (7 pyetje të anëtarëve), ndërsa në seancën e mbajtur në muajin Janar dhe në seancën e muajit Qershor anëtarët e këtij kuvendi nuk kanë treguar interesim në parashtrimin e pyetjeve.



**Nga 41 anëtarë të Kuvendit Komunal të Suharekës, 11 prej tyre ose shprehur në përqindje 26.8% e tyre kanë parashtruar pyetje të natyrave të ndryshme përdërisa 73.2% nuk kanë parashtruar asnjë pyetje gjatë periudhës Janar-Qershor 2008.**

Në vazhdim pasqyrojmë emrat e anëtarëve që kanë treguar më shumë angazhim në parashtrimin e pyetjeve gjatë kësaj periudhe:

Rexhep Manxhuka PDK 21.05%, Sami Jupa LDK 15.79%, Nazim Zenelaj LDK 10.53%, Safet Hoxha PDK 10.53%, Shkurte Morina PDK 10.53%.

**REZULTATET E NOTIMEVE PËR ANËTARËT E KUVENDIT KOMUNAL  
MALISHEVË PËR PERIUDHËN JANAR - QERSHOR 2008**

KUVENDI KOMUNAL MALISHEVË			Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave	Inicimi i çështjeve	Inicimi i rregulloreve	Amandamentimi i legjislaclionit	Pyetje parlamentare	Notimi i përgjithshëm 2008
Nr	Këshillëtarët e Kuvendit Komunal	Subjekti politik	%	%	%	%	%	%
1	Ragip Begaj	PDK	5.8%	0.9%	0.0%	0.0%	0.0%	1.7%
2	Mursel Gashi**	PDK	14.2%	1.9%	0.0%	7.9%	6.9%	7.7%
3	Hasime Krasniqi	PDK	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
4	Naim H. Morina ***	PDK	2.2%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.6%
5	Naim Kryeziu	PDK	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
6	Naim Morina***	PDK	0.9%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.2%
7	Merita Krasniqi	PDK	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
8	Afrim Zogaj	PDK	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
9	Haki Kryeziu	PDK	1.3%	0.9%	0.0%	0.0%	0.0%	0.6%
10	Rajmonda Krasniqi	PDK	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
11	Besim Dobruna	PDK	0.4%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.1%
12	Lumni Kryeziu	PDK	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
13	Sinan Gegaj	PDK	1.8%	0.9%	0.0%	2.6%	0.0%	1.3%
14	Shukrie Bytyqi	PDK	1.3%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.3%
15	Qamil Hoti	PDK	5.3%	5.6%	0.0%	2.6%	10.3%	6.0%
16	Zemrie Lima	PDK	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
17	Januz Kastrati**	LDK	27.9%	44.9%	0.0%	55.3%	31.0%	39.8%
18	Fetah Rudi	LDK	1.3%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.3%
19	Milazim Kryeziu	LDK	0.4%	0.0%	0.0%	2.6%	0.0%	0.8%
20	Ramadan Buzhala	LDK	4.9%	4.7%	0.0%	0.0%	10.3%	5.0%
21	Zahide Kastrati	LDK	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
22	Sadri Robaj	LDK	9.7%	13.1%	0.0%	2.6%	10.3%	8.9%
23	Adem Krasniqi	LDK	5.3%	3.7%	0.0%	2.6%	6.9%	4.6%
24	Bukurie Mazreku	LDK	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
25	Hamdi Mazreku	LDK	9.3%	15.9%	0.0%	23.7%	13.8%	15.7%
26	Remzie Thaqi	LDK	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
27	Sadbere Hoxha	LDK	0.4%	0.9%	0.0%	0.0%	0.0%	0.3%
28	Alban Kastrati	AKR	1.8%	0.9%	0.0%	0.0%	0.0%	0.7%
29	Milazim Rudi	LDD	0.9%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.2%
30	Avni Robaj ***	AAK	2.2%	1.9%	0.0%	0.0%	6.9%	2.7%
31	Sefer Avdiaj	ORA	2.7%	3.7%	0.0%	0.0%	3.4%	2.5%

Rezultatet e notimeve për subjektet politike në seanca			Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave	Inicimi i çështjeve	Inicimi i rregulloreve	Amandamentimi i legjislaclionit	Pyetje Parlamentare	Notimi i përgjithshëm 2008
Nr	Subjektet politike	Numri i anëtarëve						
1	PDK	16	35.2%	12.4%	0.0%	13.5%	19.2%	20.1%
2	LDK	11	57.7%	82.0%	0.0%	86.5%	69.2%	73.8%
3	AKR	1	1.0%	1.1%	0.0%	0.0%	0.0%	0.5%
4	LDD	1	1.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.3%
5	AAK	1	2.6%	2.2%	0.0%	0.0%	7.7%	3.1%
6	ORA	1	2.6%	2.2%	0.0%	0.0%	3.8%	2.2%

Me 28.03.2008, Isuf Morina dhe Adem Berisha nga radhët e PDK janë zëvendësuar me Naim H. Morina dhe Naim Morina, Bahkim Krasniqi nga radhët e AAK është zëvendësuar me Avni Robaj.

**LEGJENDA**

\* - Kryetari i AK-së

\*\* - Shefat e Grupeve Parlamentare

\*\*\* - Anëtarët e ri të Kuvendit

Rr - Rregulloret e propozuara

## NOTIMI I PËRGJITHSHËM

Kuvendi Komunal i Malishevës numëron gjithsej 31 anëtarë, të cilët përfaqësojnë 6 subjekte politike (PDK, LDK, AKR, LDD, AAK, ORA).

### Anëtarët që kanë shënuar rezultatet më të kënaqshme në të gjitha kategoritë janë:

Januz Kastrati	LDK	39.8 %
Hamdi Mazreku	LDK	15.7 %
Sadri Robaj	LDK	8.9 %
Mursel Gashi	PDK	7.7 %
Qamil Hoti	PDK	6.0 %

### Anëtarët që nuk kanë shënuar asnjë rezultat në të gjitha kategoritë (0%):

Hasime Krasniqi	PDK	0.0 %
Naim Kryeziu	PDK	0.0 %
Merita Krasniqi	PDK	0.0 %
Afrim Zogaj	PDK	0.0 %
Rajmonda Kryeziu	PDK	0.0 %
Lumni Kryeziu	PDK	0.0 %
Zemrie Lima	PDK	0.0 %
Zahide Kastrati	LDK	0.0 %
Bukuriye Mazreku	LDK	0.0 %
Remzie Thaçi	LDK	0.0 %

### Anëtarët që kanë shënuar rezultatet më të ulëta në të gjitha kategoritë në përgjithësi (0.1 - 0.5%) janë:

Shukrie Bytyçi	PDK	0.3 %
Fetah Rudi	LDK	0.3 %
Sadbere Hoxha	LDK	0.3 %
Milazim Rudi	LDD	0.2 %
Naim Morina	PDK	0.2 %
Besim Dobruna	PDK	0.1 %

### Notimi i përgjithshëm i kryetarëve të gupeve parlamentare të partive politike PDK dhe LDK është si vijon:

Mursel Gashi PDK 7.7%, Januz Kastrati LDK 39.8%.

## MUNGESAT NË SEANCA


Në këtë periudhë është vërejtur pjesëmarrje e lartë e anëtarëve në seanca të Kuvendit Komunal të Malishevës dhe nuk është shënuar asnjë anëtar të ketë munguar në më shumë se 50% të seancave të mbajtura në këtë periudhë.

## TRENDI I DISKUTIMEVE


Në këtë periudhë, në shtatë seancat e mbajtura në Kuvendin Komunal të Malishevës kohën më të madhe të tyre anëtarët e kanë kaluar duke diskutuar mbi çështje të ndryshme procedurale siç janë themelimi i Qeverisë Komunale, themelimi i Komiteteve, hartimi dhe miratimi i Statutit të Komunës së Malishevës etj.

Gjatë kësaj periudhe 73% e diskutimeve kanë qenë për çështje procedurale dhe vetëm 27% e diskutimeve kanë qenë të drejtuara rreth çështjeve të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve. Në dy seancat e mbajtura gjatë muajit Maj është shënuar numri më i lartë i pjesëmarrjes së anëtarëve të Kuvendit Komunal të Malishevës në diskutime me 51% përkatësisht 48%. Në rend dite gjatë këtyre seancave pos tjerash kanë qenë edhe miratimi i Statutit të Komunës së Malishevës dhe miratimi raportit fiskal të Malishevës për vitin 2007. Në shtatë seancat e mbajtura gjatë kësaj periudhe anëtarët nga radhët e LDK-së kanë shënuar nivelin më të lartë të pjesëmarrjes së diskutime me gjithsej 57.6% të pasuar nga anëtarët e PDK-së me 35.2% të pjesëmarrjes në diskutime.

Trendi i diskutimeve të anëtarëve të kuvendit komunal në seancat Janar- Qershor 2008



Niveli i diskutimeve sipas subjektit politik



## ÇËSHJET E INICUARA

Nga 31 këshilltarë të Kuvendit Komunal të Malishevës, më aktiv në inicim të çështjeve janë treguar: Januz Kastrati LDK 44.9 %, Hamdi Mazreku LDK 15.9 %, Sadri Robaj LDK 13.1 %


Ndërkaq gjithësej 17 anëtarë të Kuvendit Komunal të Malishevës nuk kanë iniciuar çështje nga fushat me interes për qytetarët e Malishevës.

Numri më i lartë i çështjeve të ngritura kanë rezultuar në seancën e datës 5 Maj 2008 me gjithsej 21 çështje, ku ndër tjera si pik e rendit të ditës ishte shqyrtimi i Statutit të Komunës së Malishevës.


## INICIMI I ÇËSHTJEVE SIPAS SUBJEKTIT POLITIK

Në Kuvendin Komunal të Malishevës anëtarët e LDK-së prijnë për nga inicimi i çështjeve me 82% për të vazhduar me anëtarët e PDK-së me 12.4% të çështjeve të ngritura përderisa anëtarët nga radhët e AKR-së, AAK-së dhe ORA-s bashkërisht kanë ngritur vetëm 5.7 të çështjeve të përgjithshme.

Inicimi i çështjeve sipas subjektit politik



Përfaqësimi i subjekteve politike në KK



## LLOJET E ÇËSHTJEVE

Gjatë shtatë seancave të mbajtura në periudhën Janar – Qershor, nga anëtarët e Kuvendit Komunal të Malishevës janë ngritur gjithësej 114 çështje prej të cilave vetëm 40% prekin interesin e drejtpërdrejt të qytetarëve.

## RREGULLORET E INICUARA

**Gjatë shtatë seancave të mbajtura në Kuvendin Komunal të Malishevës gjatë periudhës Janar – Qershor 2008, është miratuar Rregullorja për Ngarkesa, Tarifa dhe Gjoha Komunale dhe atë në seancën e datues 7 Shkurt 2008.**

**Nga ana tjetër gjatë kësaj periudhe në Kuvendin Komunal të Malishevës janë aprovuar gjithsej 23 vendime 73% e të cilave kanë qenë në lidhje me themelimin dhe emërimin e drejtorive dhe komisioneve komunale.**

## PROPOZIMI I AMANDAMENTEVE

Gjatë shtatë seancave të mbajtura në periudhën Janar – Qershor 2008 në Kuvendin Komunal të Malishevës janë propozuar gjithsej 38 amendamente. Ndër të cilat 86.5% e amendamenteve janë propozuar nga radhët e LDK ndërsa 13.5% të amendamenteve janë propozuar nga radhët e PDK.

Numri më i madh i amendamenteve nga ana e anëtarëve të Kuvendit Komunal të Malishevës është bërë gjatë seancës së datës 30 Maj 2008 kur në rend dite pos tjerash ka qenë edhe diskutimi dhe marja e vendimit për hedhjen në diskutim publik të Projekt Statutit të Komunës së Malishevës.


Anëtarët që kanë propozuar numrin më të lartë të amendamenteve janë Januz Kastrati (LDK) 55.3% dhe Hamdi Mazreku (LDK) me 23.7% të amendamenteve

## PYETJET E PARASHTRUARA GJATË SEANCAVE


Anëtarët e Kuvendit Komunal të Malishevës gjatë periudhës Janar – Qershor 2008 kanë bërë gjithsej 29 pyetje të natyrave të ndryshme.

Anëtarët e LDK-së në Malishevës prijnë me numrin e pyetjeve të bëra gjatë kësaj periudhe me gjithsej 69.2% të pyetjeve, ndërsa anëtarët e PDK-së me 19.2% të pyetjeve të përgjithshme.

Amandamentimet



Pyetjet Parlamentare



**Nga 31 anëtarë sa numëron Kuvendi Komunal i Malishevës, gjatë shtatë seancave të mbajtura në periudhën Janar – Qershor 2008 gjithsej 22 këshilltarë nuk kanë bërë asnjë pyetje.**

Vlen të theksohet se nga 9 anëtarë të gjinisë femërore të Kuvendit Komunal, gjatë shtatë seancave të mbajtura në periudhën Janar – Qershor 2008 nuk është shtruar asnjë pyetje ndaj ekzekutivit të kësaj komune. Seancat e datës 30 Maj, ku në rend dite pos tjerash kanë qenë edhe ndërtimi i akumulacionit të lumit Mirusha dhe subvencionimi i kompanisë e cila do të merret me riciklimin e mbeturinave plastike në Komunën e Malishevës, janë seancat në të cilat janë shtruar numri më i madh i pyetjeve të anëtarëve të Kuvendit Komunal të Malishevës ndaj ekzekutivit të kësaj komune

Anëtarët që kanë bërë më së shumti pyetje gjatë kësaj periudhe janë: Januz Kastrati LDK 31 % dhe Hamdi Mazreku LDK 13 % të pyetjeve të përgjithshme

**REZULTATET E NOTIMEVE PËR ANËTARËT E KUVENDIT KOMUNAL RAHOVEC PËR PERIUHDËN JANAR - QERSHOR 2008**

KUVENDI KOMUNAL RAHOVEC			Pjesëmarrja në diskutime gjatë seanceve	Inicimi i çështjeve	Inicimi i rregulloreve	Amandamentimi i legjislativionit	Pyetje parlamentare	Notimi i përgjithshëm 2008
Nr	Këshillëtarët e Kuvendit Komunal	Subjekti politik	%	%	%	%	%	%
1	Baton Cena	PDK	1.1%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.3%
2	Beatrisa Demiri	PDK	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
3	Haxhi Dellova***	PDK	1.1%	1.7%	0.0%	0.0%	4.0%	1.7%
4	Diellza Hoxha	PDK	1.1%	0.0%	0.0%	0.0%	4.0%	1.3%
5	Drita Vuçitërna	PDK	1.6%	3.4%	0.0%	0.0%	0.0%	1.3%
6	Vebi Muharremi***	PDK	0.5%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.1%
7	Jahja Shehu	PDK	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
8	Lumturije Ukimeraj	PDK	1.1%	1.7%	0.0%	0.0%	0.0%	0.7%
9	Xhemajli Haxhimustafa**	PDK	10.4%	12.1%	0.0%	9.1%	8.0%	9.9%
10	Xhevdet Duraku	PDK	2.7%	1.7%	0.0%	0.0%	0.0%	1.1%
11	Avdullah Kryeziu	LDK	7.7%	8.6%	0.0%	0.0%	12.0%	7.1%
12	Bedredin Shehu	LDK	8.2%	0.0%	0.0%	0.0%	8.0%	4.1%
13	Ganimete Dellova	LDK	0.5%	0.0%	0.0%	0.0%	4.0%	1.1%
14	Ibrahim Hoti	LDK	1.1%	0.0%	0.0%	0.0%	4.0%	0.3%
15	Kujtim Popaj	LDK	2.7%	1.7%	0.0%	0.0%	0.0%	1.1%
16	Nahit Elshanj**	LDK	14.3%	20.7%	0.0%	0.0%	4.0%	9.7%
17	Nazife Hundozi	LDK	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
18	Shahzije Vuçitërna	LDK	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
19	Agim Thaçi	AAK	4.4%	6.9%	0.0%	90.9%	0.0%	25.6%
20	Enver Sylka**	AAK	11.5%	15.5%	0.0%	0.0%	8.0%	8.8%
21	Feim Fetoshi	AAK	3.8%	1.7%	0.0%	0.0%	0.0%	1.4%
22	Hysnije Sylka	AAK	1.1%	0.0%	0.0%	0.0%	4.0%	1.3%
23	Rukije Krasniqi	AAK	0.5%	0.0%	0.0%	0.0%	4.0%	1.1%
24	Bajram Morina	AKR	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
25	Zana Sharku	AKR	1.1%	1.7%	0.0%	0.0%	0.0%	0.7%
26	Hamëz Alirifa	LDD	2.2%	1.7%	0.0%	0.0%	0.0%	1.0%
27	Sahadete Dula	LDD	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
28	Floriqe Boshnjaku	LKÇK	9.3%	3.4%	0.0%	0.0%	20.0%	8.2%
29	Salih Hoti	LKÇK	11.5%	17.2%	0.0%	0.0%	20.0%	12.2%
30	Hamdi Dërmala	PD	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
31								
Rezultatet e notimeve për subjektet politike në seanca			Pjesëmarrja në diskutime gjatë seanceve	Inicimi i çështjeve	Inicimi i rregulloreve	Amandamentimi i legjislativionit	Pyetje Parlamentare	Notimi i përgjithshëm 2008
Nr	Subjektet politike	Numri i anëtarëve						
1	PDK	10	19.8%	20.7%	0.0%	9.1%	16.0%	15.3%
2	LDK	8	34.6%	31.0%	0.0%	0.0%	28.0%	19.7%
3	AAK	5	21.4%	24.1%	0.0%	90.9%	16.0%	43.7%
4	AKR	2	1.1%	1.7%	0.0%	0.0%	0.0%	0.6%
5	LDD	2	2.2%	1.7%	0.0%	0.0%	0.0%	0.6%
6	LKÇK	2	20.9%	20.7%	0.0%	0.0%	40.0%	20.2%
7	PD	1	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%

Me dt.22.04.2008 Dervish Çadaku dhe Hamëz Rama nga radhët e PDK është zëvendësuar me Haxhi Dellova dhe Vebi Muharremi

**LEGJENDA**

\* - Kryetari i AK-së

\*\* - Shefat e Grupeve Parlamentare

\*\*\* - Anëtarët e ri të Kuvendit

Rr - Rregulloret e propozuara



## NOTIMI I PËRGJITHSHËM

Kuvendi Komunal i Rahovecit numëron gjithsej 31 anëtarë, të cilët përfaqësojnë 7 subjekte politike (PDK, LDK, AAK, LKÇK, AKR, LDD dhe PD).

### Anëtarët që kanë shënuar rezultatet më të kënaqshme në të gjitha kategoritë janë:

Agim Thaçi	AAK	25.6 %
Salih Hoti	LKÇK	12.2 %
Xhemajli Haxhimustafa	PDK	9.9 %
Nahit Elshani	LDK	9.7 %
Enver Sylka	AAK	8.8 %
Floriqe Boshnjaku	LKÇK	8.2 %
Bedredin Shehu	LDK	4.1 %

### Anëtarët që nuk kanë shënuar asnjë rezultat në të gjitha kategoritë (0%):

Beatrisa Demiri	PDK	0%
Jahja Shehu	PDK	0%
Nazife Hundozi	LDK	0%
Shahzije Vuçitërna	LDK	0%
Bajram Morina	AKR	0%
Sahadete Dula	LDD	0%
Hamdi Dërmala	PD	0%

### Anëtarët që kanë shënuar rezultatet më të ulëta në të gjitha kategoritë në përgjithësi (0.1 - 0.7%) janë:

Vebi Muharremi	PDK	0.1%
Baton Cena	PDK	0.3%
Ibrahim Hoti	LDK	0.3%
Lumturije Ukimeraj	PDK	0.7%
Zana Sharku	AKR	0.7%

**Notimi i përgjithshëm i kryetarëve të gupeve parlamentare të partive politike, PDK, LDK dhe AAK është si vijon:** Xhemajli Haxhimustafa PDK 9.9%, Nahit Elshani LDK 9.7%, Enver Sylka AAK 8.8%

## MUNGESAT NË SEANCA

Gjatë katër mbledhjeve të mbajtura në periudhën Janar – Qershor 2008 në Kuvendin Komunal të Rahovecit me pjesëmarrje më të ulët në seanca është evidentuar Jahja Shehu (PDK) me 50% të pjesëmarrjes.

## TRENDI I DISKUTIMEVE

Në katër seancat e mbajtura gjatë periudhës Janar – Qershor 2008 anëtarët e Kuvendit Komunal të Rahovecit pjesën më të madhe të kohës së tyre e kanë kaluar duke diskutuar për çështje të ndryshme procedurale si numri i drejtorive, themelimi i komiteteve, raporti periodik i Kryetarit të Komunës së Rahovecit etj.


Gjatë kësaj periudhe, 56% e diskutimeve të anëtarëve të Kuvendit Komunal të Rahovecit kanë qenë për çështje procedurale dhe 44% e diskutimeve të tyre kanë qenë të drejtuara rreth çështjeve të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve.

Pjesëmarrja më e lartë në diskutime e anëtarëve të Kuvendit Komunal të Rahovecit është shënuar në seancën e muajit Prill me 61%.


Në seancën në fjalë në rend dite pos tjerash ka qenë edhe Raporti i Auditorit për vitin 2006 dhe shqyrtimi i Statutit të Komunës së Rahovecit. Anëtarët e Kuvendit Komunal të Rahovecit nga radhët e LDK-së kanë shënuar nivelin më të lartë të pjesëmarrjes në diskutime gjatë katër seancave të mbajtura në periudhën Janar – Qershor 2008 me 34.6% përderisa anëtarët e AAK-së dhe LKÇK-së me 21.4% përkatësisht 20.9%.

Pjesëmarrjen më të lartë në diskutime gjatë kësaj periudhe e ka shënuar Nahit Elshani (LDK) me 14.3% të diskutimeve të përgjithshme.

Trendi i diskutimeve të anëtarëve të kuvendit komunal në seancat Janar- Qershor 2008



Niveli i diskutimeve sipas subjektit politik



Përfaqësimi i subjekteve politike në KK


## ÇËSHJET E INICUARA

Nga 31 anëtarë sa numëron Kuvendi Komunal i Rahovecit gjatë katër seancave të mbajtura në periudhën Janar – Qershor 2008 gjithsej 15 anëtarë asnjëherë nuk kanë ngritur ndonjë çështje me interes për qytetarët apo çështje procedurale.

### INICIMI I ÇËSHTJEVE SIPAS SUBJEKTIT POLITIK


Koalicionin qeveritar e përbëjnë partitë në pozitë PDK, AKR, KDTP dhe VAKAT me gjithsej 22 anëtarë të Kuvendit komunal, ndërsa parti në opozitë LDK, AAK, LDD, ORA, PD, SDA me gjithsej 19 anëtarë të këtij kuvendi komunal.

Ndër anëtarët e Kuvendit Komunal të Rahovecit, më aktiv në inicim të çështjeve janë: Nahit Elshani LDK 20.7 % dhe Salih Hoti LKÇK 17.2 %.



Përfaqësimi i subjekteve politike në KK

Në Seancën e muajit Maj është vërejtur numri më i lartë i inicimit ku në rend dite pos tjerash kanë qenë edhe raporti tre mujor i Kryetari të Komunës së Rahovecit dhe miratimi i Statutit të Komunës së Rahovecit, e cila si rezultat i lëshimit të seancës së anëtarëve të opozitës nuk u miratua. Në Kuvendin Komunal të Rahovecit anëtarët e LDK-së prijnë për nga inicimi i çështjeve me gjithsej 31% të çështjeve të iniciuara ndërsa anëtarët nga radhët e AAK-së me 24.1% të çështjeve të iniciuara. Anëtarët e PDK-së dhe LKÇK-së kanë iniciuar nga 20.7% të çështjeve, ndërkaq anëtarët e AKR-së dhe LDD-së nga 1.7% të çështjeve



### LLOJET E ÇËSHTJEVE

Në katër seancat e mbajtura gjatë periudhës Janar – Qershor 2008 nga anëtarët e Kuvendit Komunal të Rahovecit janë iniciuar gjithsej 57 çështje prej të cilave vetëm 43% çështje nga fushat me ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve të Rahovecit.

## RREGULLORET E INICUARA

Në katër seancat e mbajtura në periudhën Janar – Qershor 2008 në Kuvendin Komunal të Rahovecit nuk është iniciuar asnjë rregullore qoftë nga anëtarët e Kuvendit qoftë nga ekzekutivi i kësaj komune.

Nga ana tjetër, në periudhën Janar – Qershor 2008 në Kuvendin Komunal të Rahovecit janë aprovuar gjithsej 22 vendime përkatësishtë 81% e të cilave kanë qenë vendime në lidhje me themelimin dhe emërimin e drejtorive, komiteteve etj.

## PROPOZIMI I AMANDAMENTEVE



Nga katër seancat e mbajtura në periudhën Janar – Qershor 2008 në Kuvendin Komunal të Rahovecit vetëm në seancën e muajit Prill janë propozuar amendamente. Nga gjithsej 11 amendamentet e propozuara në këtë seancë 10 prej tyre janë propozuar nga Agim Thaçi (AAK) dhe 1 amendament ka propozuar Xhemajli Haxhimustafa (PDK). Që të gjitha amendamentimet që janë propozuar gjatë kësaj seance kanë qenë në lidhje me Statutin e Komunës së Rahovecit e cila ka qenë si pikë e rendit të ditës në atë seancë.

## PYETJET E PARASHTRUARA GJATË SEANCEVE

Anëtarët e Kuvendit Komunal të Rahovecit gjatë katër seanceve të mbajtura në periudhën Janar – Qershor 2008 kanë bërë gjithsej 25 pyetje ndaj ekzekutivit të kësaj komune. Anëtarët e LKÇK-së në Komunën e Rahovecit prijnë me numrin e pyetjeve të bëra gjatë kësaj periudhe me gjithsej 40% të pyetjeve të bëra ndërsa anëtarët e LDK-së kanë bërë 28% të pyetjeve të përgjithshme.

Anëtarët e Kuvendit Komunal të Rahovecit nga radhët e AKR-së, LDD-së dhe PD-së gjatë seanceve të mbajtura në periudhën Janar – Qershor nuk kanë bërë asnjë pyetje. Anëtarët që kanë bërë më së shumti pyetje gjatë kësaj periudhe janë Florije Boshnjaku (LKÇK) dhe Salih Hoti (LKÇK) me nga 20% të pyetjeve të përgjithshme.

**Trendi më i lartë i pyetjeve të parashtruara është shënuar në muajin Maj me 36% ku pikë e rendit të ditës ka qenë raporti tre mujor i Kryetarit të Komunës.**



**REZULTATET E NOTIMEVE PËR ANËTARËT E KUVENDIT KOMUNAL  
DRAGASH PËR PERIUHDËN JANAR - QERSHOR 2008**

KUVENDI KOMUNAL DRAGASH			Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave	Inicimi i çështjeve	Inicimi i rregulloreve	Amandamentimi i legjislacionit	Pyetje parlamentare	Notimi i përgjithshëm 2008
Nr	Këshillëtarët e Kuvendit Komunal	Subjekti politik	%	%	%	%	%	%
1	Adelina Qafleshi	PDK	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
2	Arbnore Kurtishi	PDK	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%
3	Ibrahim Gashi	PDK	3.4%	4.5%	0.0%	9.1%	4.0%	5.2%
4	Indire Gashi	PDK	0.5%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.1%
5	Lulzim Rifaj	PDK	10.1%	16.4%	0.0%	0.0%	0.0%	6.6%
6	Mitat Fejza	PDK	8.2%	3.0%	0.0%	0.0%	4.0%	3.8%
7	Shaban Shabani	PDK	5.3%	4.5%	0.0%	0.0%	4.0%	3.4%
8	Ilirjana Sallahu	LDK	0.5%	0.0%	0.0%	0.0%	0.0%	0.1%
9	Majlinda Pirkuçaj	LDK	0.5%	1.5%	0.0%	0.0%	0.0%	0.5%
10	Naim Ramadani	LDK	11.6%	10.4%	0.0%	9.1%	16.0%	11.8%
11	Ymer Ademi	LDK	7.7%	11.9%	0.0%	27.3%	12.0%	14.7%
12	Xhemal Iljazi	LDK	3.9%	1.5%	0.0%	0.0%	4.0%	2.3%
13	Irfan Ibrahimimi	VAKAT	1.4%	1.5%	0.0%	0.0%	0.0%	0.7%
14	Sabidin Çufta	VAKAT	8.7%	1.5%	0.0%	27.3%	4.0%	10.4%
15	Zinaida Elmazi	VAKAT	1.9%	1.5%	0.0%	0.0%	0.0%	0.9%
16	Ahmet Beširi	GIG	2.9%	3.0%	0.0%	0.0%	0.0%	1.5%
17	Haćima Nešković	GIG	1.9%	6.0%	0.0%	0.0%	4.0%	3.0%
18	Mahmut Mahmuti	AAK	9.7%	13.4%	0.0%	0.0%	8.0%	7.8%
19	Mujdin Jusufi	AKR	4.3%	3.0%	Rr	0.0%	12.0%	4.8%
20	Qamil Kolloni	LDD	13.0%	13.4%	0.0%	27.3%	24.0%	19.4%
21	Nihat Osmani	SDA	4.3%	3.0%	0.0%	0.0%	4.0%	2.8%
Rezultatet e notimeve për subjektet politike në seanca			Pjesëmarrja në diskutime gjatë seancave	Inicimi i çështjeve	Inicimi i rregulloreve	Amandamentimi i legjislacionit	Pyetje Parlamentare	Notimi i përgjithshëm 2008
Nr	Subjektet politike	Numri i anëtarëve						
1	PDK	7	96.4%	27.5%	28.4%	0.0%	9.1%	12.0%
2	LDK	5	90.0%	24.2%	25.4%	0.0%	36.4%	32.0%
3	VAKAT	3	100.0%	12.1%	4.5%	0.0%	27.3%	4.0%
4	GIG	2	87.5%	4.8%	9.0%	0.0%	0.0%	4.0%
5	AAK	1	100.0%	9.7%	13.4%	0.0%	0.0%	8.0%
6	AKR	1	100.0%	4.3%	3.0%	Rr	0.0%	12.0%
7	LDD	1	100.0%	13.0%	13.4%	0.0%	27.3%	24.0%
8	SDA	1	100.0%	4.3%	3.0%	0.0%	0.0%	4.0%

**LEGJENDA**

\* - Kryetari i AK-së

\*\* - Shefat e Grupeve Parlamentare

\*\*\* - Anëtarët e ri të Kuvendit

Rr - Rregulloret e propozuara

## NOTIMI I PËRGJITHSHËM

Kuvendi Komunal i Dragashit numëron gjithsej 21 anëtarë, të cilët përfaqësojnë 8 subjekte politike (PDK, LDK, VAKAT, GIG, AAK, AKR, LDD, SDA).

### Anëtarët që kanë shënuar rezultatet më të kënaqshme në të gjitha kategoritë janë:

Qamil Kolloni	LDD	19.4 %
Ymer Ademi	LDK	14.7 %
Naim Ramadani	LDK	11.8 %
Sabidin Ćufta	VAKAT	10.4 %
Mahmut Mahmuti	AAK	7.8 %
Lulzim Rifaj	PDK	6.6 %
Ibrahim Gashi	PDK	5.2 %

### Anëtarët që nuk kanë shënuar asnjë rezultat në të gjitha kategoritë (0%):

Adelina Qafleshi	PDK	0 %
Arbnore Kurtishi	PDK	0 %

### Anëtarët që kanë shënuar rezultatet më të ulëta në të gjitha kategoritë në përgjithësi (0.1-0.9%) janë:

Zinaida Elmazi	VAKAT	0.9 %
Irfan Ibrahim	VAKAT	0.7 %
Majlinda Pirkuqi	LDK	0.5 %
Indire Gashi	PDK	0.1 %
Ilirjana Sallahu	LDK	0.1 %

(Në bazë të këtyre të dhënave anëtarët me performancë më të lartë janë Qamil Kolloni (LDD) me 19.5% dhe Ymer Ademi (LDK) 14.7%. Ndërkaq anëtarët me notë me të ulët janë Adelina Qafleshi (PDK) 0% dhe Arbnore Kurtishi (PDK) 0%)

Vlen të theksohet se efikasiteti i anëtareve të gjinisë femërore në Kuvendin Komunal të Dragashit është mjaft i ulët. Nga 7 anëtare të gjinisë femërore të pranishme në Kuvendin Komunal të Dragashit, 85% prej tyre janë vlerësuar me më pak se 1% në të gjitha kategoritë. Ndërkaq këshilltarja më e suksesshme është Haćima Nećković me notë 3.0%.

## MUNGESAT NË SEANCA

Në këtë periudhë është vërejtur pjesëmarrje e lartë e anëtarëve në seanca të Kuvendit Komunal të Dragashit dhe vetëm 4 anëtarë kanë munguar në njërin nga 4 seancat e mbajtura gjatë kësaj kohe.

## TRENDI I DISKUTIMEVE


Në këtë periudhë, në katër seancat e mbajtura në Kuvendin Komunal të Dragashit kohën më të madhe të tyre anëtarët e kanë kaluar duke diskutuar mbi çështje të ndryshme procedurale siç janë themelimi i Qeverisë Komunale, themelimi i Komiteteve, hartimi dhe miratimi i Statutit të Komunës së Dragashit etj.

Gjatë kësaj periudhe 73% e diskutimeve kanë qenë për çështje procedurale dhe vetëm 27% e diskutimeve kanë qenë të drejtuara rreth çështjeve të cilat kanë ndikim të drejtpërdrejtë në jetën e qytetarëve.


Seancat e muajit Janar dhe Shkurt kanë shënuar pjesëmarrjen më të lartë të anëtarëve në diskutime me gjithsej 76% të anëtarëve që kanë marrë pjesë në diskutime.

Në katër seancat e mbajtura gjatë kësaj periudhe anëtarët nga radhët e PDK-së kanë shënuar nivelin më të lartë të pjesëmarrjes së diskutimeve me gjithsej 27.5% të pasuar nga anëtarët e LDK-së me 24.5% të pjesëmarrjes në diskutime.

Trendi i diskutimeve të anëtarëve të kuvendit komunal në seancat Janar- Qershor 2008



Niveli i diskutimeve sipas subjektit politik



Përfaqësimi i subjekteve politike në KK

## ÇËSHTJET E INICUARA

Gjatë 4 seancave të mbajtura në periudhën Janar – Qershor nga anëtarët e Kuvendit Komunal të Dragashit janë ngritur gjithsej 67 çështje prej të cilave vetëm 28% nga fushat me interes për qytetarët e Dragashit.

### INICIMI I ÇËSHTJEVE SIPAS SUBJEKTIT POLITIK

Në Kuvendin Komunal të Dragashit anëtarët e PDK-së prijnë për nga iniciimi i çështjeve me 28.4% të çështjeve të ngritura e përcjellë nga anëtarët e LDK-së me 25.4% të çështjeve të iniciuara.



Anëtarët e SDA-së dhe AKR-së kanë numrin më të vogël të çështjeve të iniciuara me 3% të numrit të përgjithshëm të çështjeve të iniciuara.

Nga 21 anëtarë të Kuvendit Komunal të Dragashit, më aktiv në iniciim të çështjeve janë treguar:

Lulzim Rifaj PDK 16.4%, Qamil Kolloni LDD 13.4%,  
Mahmut Mahmuti AAK 13.4%, Ymer Ademi LDK 11.9%,  
Naim Ramadani LDK 10.4%

Ndërkaq Adelina Qafleshi (PDK), Arbnore Kurtishi (PDK), Indire Gashi (PDK) dhe Ilirjana Sallahu (LDK) nuk kanë ngritur asnjë çështje gjatë kësaj periudhe.

Inicimi i çështjeve sipas subjektit politik



Seanca e muajit Prill, ku pos tjerash në rend dite ka qenë edhe raportimi i Kryetarit të Komunës mbi punën e tij tre mujore, ka qenë seanca me numrin më të madh të çështjeve të ngritura me gjithsej 25 sosh.

## RREGULLORET E INICUARA

Në periudhën Janar – Qershor në Kuvendin Komunal të Dragashit është dhënë ideja për iniciimin e vetëm një rregulloreje që kishte të bënte me rregullimin e shpërblimeve gjegjësisht kompensimin e anëtarëve të Kuvendit Komunal të Dragashit.

**Në Kuvendin Komunal të Dragashit në periudhën Janar – Qershor nuk është iniciuar për miratim asnjë rregullore si nga anëtarët e Kuvendit Komunal ashtu edhe nga ekzekutivi i kësaj komune.**

Nga ana tjetër gjatë kësaj periudhe në Kuvendin Komunal të Dragashit janë aprovuar gjithsej 17 vendime 59% e të cilave kanë qenë në lidhje me themelimin dhe emërimin e drejtorive dhe komisioneve komunale.

## PROPOZIMI I AMANDAMENTEVE

